

## SHTOJCA I

### TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PËRDORIMIT TË TERMINALIT TË GAZIT NATYROR TË LËNGSHËM

#### Neni 1 Objekti

Subjekti i këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme është të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet reciproke të Operatorit dhe Përdoruesve të Terminalit (këtej e tutje: Palë) dhe të përcaktojë Kushtet dhe Afatet që aplikohen për sigurimin e shërbimit të Operatorit.

#### Neni 2 Përkufizime

Termet e përdorur këtu, në rast se nuk përcaktohen ndryshe në këtë shtojcë, kanë kuptimin si të përcaktuar tek Rregullorja e GNL-së dhe rregulloret e tjera të tregut të sektorit të gazit natyror.

#### Neni 3 Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit

- (1) Për të marrë shërbimet e Operatorit, Përdoruesi i Terminalit duhet të nënshkruajë me Operatorin një Marrëveshje Përdorimi për Terminalin, pjesa përbërëse e së cilës janë edhe këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme.
- (2) Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit midis të tjerave duhet të përmbajë terma specifikë në lidhje me:
  - informacionin mbi subjektet e sektorit të gazit natyror të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit;
  - kapacitetin e rigazifikimit të GNL-së alokuar për Përdoruesit e Terminalit për një vit të gazit gjatë Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit,
  - kohëzgjatjen e Marrëveshjes së Përdorimit Terminalit dhe
  - kushte të tjera siç mund të bien dakord midis Operatorit dhe Përdoruesit të Terminalit.

#### Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet që lindin nga Shërbimi i Kontraktuar

- (1) Operatori dhe Përdoruesi i Terminalit duhet të kryejë shërbimet e kontraktuara në përputhje me dispozitat e përcaktuara tek Rregullorja e GNL-së, tek këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme dhe tek Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit.
- (2) Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së ka këto detyra:
  1. operon, mirëmban e zhvillon një impiant GNL-je të sigurt, të qëndrueshëm dhe eficient,

- për të siguruar një treg të hapur, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe garanton mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit;
2. merr miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me nenin 11 të ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” të ndryshuar;
  3. lidh impiantin e GNL-së me sistemin e transmetimit, në përputhje me rregullat teknike të sistemit të transmetimit dhe me rregullat për përdorimin e impianteve të GNL-së;
  4. vendos një sistem matës të rrjedhave hyrëse dhe dalëse, si dhe të parametrave të cilësisë së gazit;
  5. shkarkon dhe rigazifikon GNL-në, sipas kontratave të nënshkruara;
  6. siguron kushte objektive, të njëjta dhe jodiskriminuese, për akses në impiantin e GNL-së, sipas dispozitave të ligjit 102/2015“Për Sektorin e Gazit Natyror” të ndryshuar; dhe kushteve të përgjithshme të furnizimit me gaz natyror, të miratuara nga ERE, sipas neneve 16 e 75 të këtij ligji;
  7. i siguron çdo operatori tjetër të sistemit, informacion të mjaftueshëm për të garantuar që transportimi dhe depozitimi i gazit natyror të bëhen në përputhje me operimin e sigurt dhe eficient të sistemeve të ndërlidhura;
  8. siguron, paraprakisht, brenda një afati të arsyeshëm, informacion të rregullt për pjesëmarrësit e tregut të gazit, për vëllimin dhe datën e mbylljes së operimit të impiantit të GNL-së dhe reduktimin e pritshëm të kapaciteteve të impiantit të GNL-së;
  9. mbron informacionin konfidencial, me natyrë tregtare, të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- (3) Operatori i Sistemit të Impiantit të GNL-së ka të drejtë që:
1. të refuzoj aksesin në impiant, në rastet e parashikuara në nenet 43 e 79 të ligjit 102/2015“Për Sektorin e Gazit Natyror” të ndryshuar;
  2. të blej gaz natyror për konsumin e vet dhe për mbulimin e humbjeve të gazit në impiantin e GNL-së;
  3. të kufizoj ose të ndaloj, përkohësisht, shkarkimin dhe rigazifikimin e GNL-së, në rast të:
    - një kërcënimi të drejtpërdrejtë të jetës së njerëzve, shëndetit dhe pasurisë, me qëllim eliminimin e kërcënimeve të tilla;
    - një situatë krize dhe me qëllim parandalimin e saj;
    - punimeve të planifikuara të mirëmbajtjes dhe të rindërtimit të impianteve të GNL-së;
    - mosrespektimit, nga një përdorues, të detyrimeve të tij kontraktuale.
- (4) Përdoruesi i Terminalit ka të drejtë të:
1. Ketë akses në Terminal në përputhje me dispozitat e ligjeve që rregullojnë tregun e gazit natyror, Rregullat e GNL-së si dhe me Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit.
  2. Përdor shërbimin të kontraktuar në përputhje me Rregullat dhe Përdorimin e Terminalit.
  3. Tregëtoj kapacitetet e papërdorura në tregun sekondar në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave.

## **Neni 5**

### **Shërbimet e kyera në Terminal**

(5) Përdoruesi i Terminalit duhet të:

- Shlyejë plotësisht faturat e lëshuara nga Operatori për shërbimet në terminal dhe detyrime të tjera pagese kur ato dalin nga Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit, dhe duhet ti dorëzojë Operatorit instrumentin e sigurisë së pagesës (Garancin Bankare) në përputhje me këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme;
- të sigurojë kushte teknike për të komunikuar me Operatorin;
- të sigurojë që sasisa e GNL-së e shpërndarë është në përputhje me specifikimin e cilësisë së GNL-së;
- që përdorimi i shërbimeve të jetë në përputhje me axhendat e miratuara të shërbimeve;
- që përdorimi i shërbimeve të Terminalit të jetë në përputhje me kushtet teknike të Terminalit;
- që për çdo ndryshim tek rrethanat që mund të çojnë në përfundimin e Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit ose që kanë të bëjnë me zbatimin e Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit të njoftojë Operatorin;
- të jetë përgjegjës për transportimin dhe ankorimin e secilës ngarkesë që Përdoruesi i Terminalit ka të drejtë të shkarkojë në Terminal në përputhje me Kushtet Teknike të Terminalit dhe Rregullat;
- të sigurohet që kapaciteti i sistemit të transmetimit ose furnizuesi i gazit ka marrë gazin prej tyre në dalje të Terminalit që është gjithashtu hyrja në sistemin e transmetimit në përputhje me Rregullat, dhe
- të garantojë konfidencialitetin e informacioneve që janë vënë në dispozicion të Përdoruesit të Terminalit.

## **Neni 6**

### **Tarifa e shërbimit të rigazifikimit**

(1) Përdoruesi i Terminalit duhet të paguajë tarifën e shërbimit të rigazifikimit në Terminal, pavarësisht nëse ata e kanë përdorur apo jo shërbimin e rigazifikimit të GNL dhe që korrespondon me kapacitetet e kontraktuara të rigazifikimit të GNL.

(2) Tarifa e shërbimit të rigazifikimit përcaktohet dhe llogaritet në përputhje me Metodologjinë e llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit për operatorin e sistemit të GNL-së të miratuar nga ERE.

## **Neni 7**

### **Pagesat dhe Metoda e faturimit**

(1) Operatori duhet ti dorëzojë Përdoruesit të Terminalit një faturë për shërbimet e ofruara në muajin e kaluar jo më vonë se dita e 15 e muajit aktual.

(2) Faturat e lëshuara nga Operatori do të likujdohen nga Përdoruesi I Terminalit brënda 15 ditë nga data në të cilën Operatori lëshoi faturën.

(3) Nëse dita e fundit e afatit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni i takon një dite

që nuk është ditë pune, dita e ardhshme e punës llogaritet si dita e fundit e afatit.

(4) Detyrimi i pagesës do të konsiderohet i kryer në datën kur pagesat kanë kaluar tek llogaria e Operatorit.

(5) Data e pagesës do të fillojë në datën e faturimit të treguar në faturë.

(6) Për çdo ditë vonesë në pagimin e tarifave, Përdoruesi i Terminalit do të paguajë interesin e parazgjedhur ligjor të vlefshëm për periudhën përkatëse.

(7) Në rast të ndonjë mospërputhjeje brënda zërave individualë ose shumave të faturuara nga Operatori, Përdoruesi i Terminalit do të ketë të drejtë t'i dërgojë Operatorit një kundërshtim me shkrim, duke përmendur zërat dhe arsyet përkatëse për një mosmarrëveshje të tillë dhe shumën e diskutuar (këtu dhe më poshtë: Njoftimi i Mospërputhjes)

(8) Përdoruesi i Terminalit duhet të tregojë zërat dhe arsyet e kundërshtimit të faturës dhe të tregojë shumën e kundërshtuar.

(9) Pasi Operatori të marrë Njoftimin për Mospërputhje referuar në paragrafin 1 të këtij Neni, Operatori do t'i përgjigjet këtij njoftimi jo më vonë se 10 ditë.

(10) Operatori dhe Përdoruesi i Terminalit duhet të përpiqen të arrijnë në një marrëveshje me shkrim në mirëbesim brënda 10 ditësh kalendarike nga data në të cilën Përdoruesi i Terminalit ka marrë përgjigjen e Operatorit, që do të thotë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e përgjigjes në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.

(11) Njoftimi për mospërputhje të faturës nga paragrafi 10 i këtij neni nuk e shtyn pagimin e detyrimeve të papaguara sipas faturës së marrë.

(12) Të gjitha shumat e specifikuar tek këto Kushte dhe Terma të Përgjithshme do të konsiderohen të jenë pa TVSH, derisa të specifikohet ndryshe. Nëse TVSH-ja është e ngarkueshme për çdo pagesë të bërë nga një Palë në lidhje me Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit ose përfundimin e Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, Pala që bën pagesën do t'i paguajë Palës që merr pagesën një shumë të barabartë me TVSH-në, përveç pagesës të shumës që duhet paguar.

(13) Operatori nuk do të jetë përgjegjës për kostot dhe shpenzimet e bëra për një palë të tretë nga Përdoruesi i Terminalit, duke përfshirë të gjitha detyrimet doganore dhe / ose të importit, akcizat, taksën e transportit ose taksat e tjera në lidhje me GNL, tarifin e portit dhe shërbimet e pilotimit, dhe të gjitha shpenzimet e tjera të ngjashme që lidhen me Transportuesin GNL.

## **Neni 8**

### **Garancia Bankare për permbushjen e detyrimeve**

(1) Në mënyrë që të sigurojë të gjitha detyrimet e pagesave të Përdoruesve të Terminalit bazuar tek Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit dhe detyrimet që rezultojnë nga

përfundimi i saj, Përdoruesi Terminal duhet të ofrojë Garancinë Bankare për Operatorin sipas këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme.

(2) Garancia Bankare do të jetë e vlefshme dhe efektive për gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes për të cilën janë kontraktuar shërbimet e rigazifikimit të GNL, nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit dhe të paktën 60 ditë pas përfundimit të Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit ose pas përmbushjes së të gjitha detyrimeve të Përdoruesit të Terminalit në rast të përfundimit të Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit.

(3) Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, për marrëveshjet e nënshkruara pas përfundimit të Proedurës së Hapur, të cilat kryhen para fillimit të planifikuar të funksionimit të Terminalit, garancia bankare do të dorëzohet në përputhje me rregullat për zbatimin e fazës së rezervimit të kapacitetit detyrues, që nënkupton jo më vonë se gjashtë muaj para funksionimit të Terminalit dhe do të rinovohet para çdo viti gazi gjatë Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit.

(4) Garancia Bankare e paraqitur gjatë dorëzimit të ofertës në procesin e prokurimit me procedurë të hapur do të jetë e vlefshme deri në momentin e dorëzimit të Garancisë Bankare të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

(5) Të gjitha shpenzimet në lidhje me Garancinë Bankare përfshirë dhe vetë Garancinë do të përballohen nga Përdoruesi Terminal.

## Neni 9

### Kontraktimi dhe çertifikata e garancisë së projektit

(1) Përdoruesi Terminal do të ofrojë Garancinë Bankare për kontraktimin e shërbimeve gjatë rezervimit vjetor të kapacitetit në përputhje me këtë nen.

(2) Përdoruesi i Terminalit me një vlerësim të paktën BBB nga S & P / Fitch ose Baa2 nga Moody's FC LT ose Përdoruesi i Terminalit pa një vlerësim të tillë, por që ka një Filial me një vlerësim të tillë, nuk do të sigurojë Garancinë Bankare për periudhën kur Terminali Përdoruesi ose Filiali i tij kanë një vlerësim të tillë, me kusht që ti dorëzojë Operatorit sa më poshtë:

1. dëshmi se Përdoruesi i Terminalit ose Filialit të tij ka një vlerësim të tillë; dhe
2. një garanci të korporatës me një klauzolë përmbarimi të lëshuar nga Përdoruesi i Terminalit (nëse Përdoruesi i Terminalit ka vlerësimin përkatës), ose një garanci të korporatës me një klauzolë të ekzekutimit të lëshuar nga Filiali (nëse Filiali ka vlerësimin përkatës), me të cilin Filiali si një garantues solidar ndaj Përdoruesit të Terminalit garanton, që Përdoruesi që përdor Terminalin do të shlyejë të gjitha borxhet që dalin nga Marrëveshja e Përdorimit Terminal. Përmbajtja e garancisë së korporatës do të jetë e pranueshme nga Operatori dhe do të specifikojë që ligji shqiptar është ligji qeverisës për detyrimet nga garancia e korporatës dhe se çdo mosmarrëveshje do të vendoset nga gjykata kompetente shqiptare.

- (3) Për kompanitë që nuk përmbushin asnjë nga kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, Përdoruesi i Terminalit do të sigurojë Garancinë Bankare në shumën që korrespondon me 50% të tarifave totale për përdorimin e Terminalit plus TVSH (nëse TVSH zbatohet) për vitin e ardhshëm të gazit.
- (4) Garancinë Bankare referuar në paragrafin 3 të këtij neni sigurohet si më poshtë:
1. një depozitë parash në euro (në qoftë se Përdoruesi i Terminalit ka një vend të regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë), ose në lekë (në qoftë se Përdoruesi i Terminalit ka një vend të regjistruar në Republikën e Shqipërisë), duke e depozituar shumën në llogarinë bankare të depozitës së Operatorit; ose
  2. një garanci bankare e pakushtëzuar dhe e pakthyeshme që paguhet "**me kërkesë të parë**" dhe "**pa kundërshtim**" nga një bankë që pranohet nga Operatori, me përmbajtjen e saj të pranueshme nga Operatori, e lëshuar për periudhën e vlefshmërisë së paku 60 ditë pas perfundimit të vitit tjetër të gazit, të cilin Përdoruesi i Terminalit do të rinovojë në përputhje me Nenin 19 të këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme, në mënyrë që Operatori gjatë gjithë periudhës së Garancia Bankare të mbajë një Garanci të vlefshme në përputhje me këto Terma dhe Kushtet e Përgjithshme.
- (5) Në rastin e kontraktimit të shërbimeve të rigazifikimit të GNL-së tek rezervimi vjetor i kapaciteteve të rigazifikimit GNL, Përdoruesi i Terminalit duhet të paraqesë Garancinë Bankare jo më vonë se 15 ditë para fillimit të vitit të gazit në të cilin është kontraktuar shërbimi, në llogarinë e Operatorit. Operatori do t'i kthejë Garancinë Bankare Përdoruesit të Terminalit me kërkesën e tij, me kusht që Përdoruesi i Terminalit të ketë përmbushur siç duhet të gjitha detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit.

## Neni 10

### Garancia Bankare për shërbimet e kontraktuara

- (1) Për shërbimet e kontraktuara gjatë Rezervimit Afatshkurtër të Kapacitetit, Garancia Bankare do të jetë për njëqind për qind (100%) e pagesave totale të përdorimit të Terminalit për vitin e kontraktuar të gazit, plus TVSH nëse ajo zbatohet, dhe sigurohet si më poshtë:
1. një depozitë cash në llogarinë bankare të Operatorit në euro (nëse Përdoruesi i Terminalit ka një vend të regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë), ose në Lekë (nëse Përdoruesi i Terminalit ka një vend të regjistruar në Republikën e Shqipërisë); ose
  2. një garanci bankare e pakushtëzuar dhe e pakthyeshme që paguhet "në mënyrë të përshpejtuar" dhe "nuk kundërshtohet" nga një bankë që pranohet nga Operatori, e lëshuar për periudhën e vlefshmërisë të paktën 60 ditë pas perfundimit të shërbimit të kontraktuar.
- (2) Përdoruesi i Terminalit do të paraqesë Garancinë Bankare jo më vonë se 15 ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit në rastin e Rezervimit Afatshkurtër të Kapacitetit.
- (3) Nëse Përdoruesi i Terminalit ose një Filial i tij që ofron një garanci pushon së vlerësuarit BBB nga S& P/ Fitch ose Baa2 nga Moody's FC LT, Përdoruesi i Terminalit do të dorëzojë Operatorit një Garancinë Bankare të re në përputhje me termat dhe

kushtet e përgjithshme, brenda 15 ditëve nga data e ndryshimit të vlerësimit.

(4) Për qëllimet e parashikuara në këto dispozita në rast se një institucion financiar që siguron Garancinë Bankare pushon së qeni i pranueshëm nga Operatori, Përdoruesi i Terminalit, me kërkesë të Operatorit, do të paraqesë brenda 15 ditëve një Garanci Bankare të re për të njëjtën sasi, terma dhe përmbajtje të pranueshme nga Operatori të lëshuar nga një institucion financiar i pranueshëm nga Operatori.

(5) Nëse Përdoruesit e Terminalit kanë kontraktuar shërbimet e rigazifikimit të GNL për disa vite radhazi të gazit, ata do të rinovojnë dhe paraqesin një garanci të re bankare jo më vonë se 15 ditë pune para fillimit të çdo viti tjetër të gazit sipas këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme.

(6) Garancia bankare do të lëshohet në formë të shkruar në gjuhën shqipe dhe dokument origjinal e shkruar me gërma latine. Nëse Përdoruesi paraqet një garanci bankare në një gjuhë të huaj, duhet të sigurohet një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe i garancisë bankare.

(7) Në rast se garancia e re bankare nuk lëshohet brenda afatit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni ose nëse institucioni financiar që lëshon garancinë bankare nuk është më i pranueshëm nga Operatori, dhe Përdoruesi i Terminalit nuk mund të sigurojë një garanci të re bankare në përputhje me termat dhe kushtet e përgjithshme, Operatori do të ketë të drejtën të tërheqë garancinë bankare dhe të depozitojë fondet përkatëse si kolateral në cash në një llogari në ruajtje të Operatorit.

(8) Për të shmangur dyshimet, Operatori nuk do ti paguajë Përdoruesit të Terminalit asnjë interes në depozitën e përmendur në paragrafin 4 të këtij neni. Në rast se Operatori ka interes në depozitë, interesi i tillë nuk do të llogaritet automatikisht në përmbushjen e detyrimeve të Përdoruesit të Terminalit sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, por ai do të shtohet në shumën totale të depozitës dhe Operatori do të autorizohet të përdorë atë sipas kushteve, të njëjtat sipas të cilave Operatori është i autorizuar të përdorë mbështetjen e kredisë sipas Termave dhe Kushteve të Përgjithshme.

(9) Nëse Përdoruesi i Terminalit nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij të pagesës sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, Operatori do të ketë të drejtën të aktivizojë dhe të përdorë garancinë bankare. Operatori nuk do të përdorë garancinë bankare për qëllimin e shlyerjes së kërkesave të papaguara ndaj Përdoruesit të Terminalit para skadimit të tre (3) ditëve (pune) nga data e maturimit të kërkesës përkatëse ndaj Përdoruesit të Terminalit.

(10) Në rastin kur Operatori përdor garancinë bankare për shlyerjen e detyrimeve të Përdoruesit të Terminalit, pavarësisht faktit nëse garancia bankare është përdorur në të gjithë shumën ose vetëm pjesërisht, Përdoruesi i Terminalit do të marrë përsipër ti dorëzojë Operatorit një Garanci Bankare, në shumën e cila korrespondon me shumën e përdorur të garancisë, brenda 10 ditëve nga data kur Operatori e përdori këtë garanci.

(11) Nëse Përdoruesi Terminalit nuk arrin të japë një Garancia Bankare brenda afatit të përmendur në paragrafin 10 të këtij neni, Operatori do të ketë të drejtën të përfundojë



## **Neni 11**

### **Dëmshpërblim nga Operatori**

(1) Operatori do të mbrojë, dëmshpërblejë dhe ruaj Përdoruesit e Terminalit ndaj të gjitha dëmtimeve, si rezultat i ndonjë pike më poshtë:

1. çdo dëmi në pronësi të Operatorit, ose në pronësi të Palës së Dëmshpërblyer të Operatorit; ose
2. çdo dëmtim personal ose vdekje (përfshirë dëmtimin fatal, sëmundjen ose pandemi) e punonjësve të Operatorit, personelit ose personelit të shërbimit ose atyre të ndonjë prej Palëve të Zhdëmtuara të Operatorit; ose
3. çdo dhe të gjitha dëmet ose dëmtimet mjedisore, përfshirë gjobat e vendosura nga një autoritet kompetent, përfshirë dëmet për kontrollin, heqjen, rehabilitimin, rivendosjen dhe pastrimin e të gjitha mbetjeve ose ndotjes, që vijnë nga ose për shkak të mbetjeve ose ndotjes që vijnë nga zjarri, krateri, kullimi, rrjedhja ose ndonjë rrjedhje tjetër e pakontrolluar ose e paligjshme e lëngjeve, gazit, ujit ose substancave të tjera, që burojnë nga ndonjë prej pronave të Operatorit ose prona e ndonjë prej Palëve të Zhdëmtuara të Operatorit, përfshirë derdhjet ose rrjedhjet e karburantit, lubrifikantëve, vajrave , ngjitës, bojëra, tretës, çakëll, mbeturina ose kanalizim.

## **Neni 12**

### **Dëmshpërblimi nga Përdoruesi i Terminalit**

(1) Përdoruesi i Terminalit duhet të mbrojë, dëmshpërblejë dhe mbajë Palët që do të Dëmshpërblehen nga Operatori ndaj çdo dhe të gjitha dëmtimeve, si rezultat i ndonjë pike më poshtë:

1. çdo dëmi në pronësi të Përdoruesit të Terminalit, ose në pronësi të Palës së Dëmshpërblyer të Përdoruesit të Terminalit; ose
2. çdo dëmtim personal ose vdekje (përfshirë dëmtimin fatal, sëmundjen) e cilitdo prej punonjësve, personelit ose stafit të shërbimit të Përdoruesit të Terminalit ose atyre të ndonjë prej Palëve të Dëmshpërblyera të Përdoruesit të Terminalit; ose
3. çdo dhe të gjitha dëmet ose dëmtimet mjedisore, përfshirë gjobat e vendosura nga një autoritet kompetent, përfshirë dëmet për kontrollin, heqjen, rehabilitimin, rivendosjen dhe pastrimin e të gjithë mbeturinave ose ndotjes, që vijnë nga ose për shkak të mbeturinave ose ndotjes që vijnë nga zjarri, krateri, kullimi, rrjedhja ose ndonjë rrjedhje tjetër e pakontrolluar ose e paligjshme e lëngjeve, gazit, ujit ose substancave të tjera, që burojnë nga ndonjë prej pronave të Përdoruesit të Terminalit ose prona të ndonjë prej Palëve të Dëmshpërblyera të Përdoruesit të Terminalit, përfshirë derdhjet ose rrjedhjet e karburantit, lubrifikantëve, vajrave, ngjitës, bojëra, tretës, çakëll, ujë, mbeturina ose kanalizim.

(2) Pala e cila ka të drejtën e dëmshpërblimit në përputhje me Termat dhe Kushtet të Përgjithshme duhet të informojë menjëherë palën tjetër që është e detyruar të kompensojë çdo kërkesë për dëmet që do të dëmshpërblehen.

(3) Pala që ka të drejtën e kompensimit do të ketë të drejtë të kontestojë, të mbrojë dhe të



fillojë një proces gjyqësor (dhe të angazhojë këshilltar ligjor sipas zgjedhjes së tij në lidhje me sa më sipër) në lidhje me çdo kërkesë, veprim, padi ose procedim nga ndonjë palë tjetër që pretendon ose kundër së cilës pretendohet, dhe që rezulton nga çdo çështje në lidhje me të cilën ata kanë të drejtë për dëmshpërblim, ndërsa shpenzimet e arsyeshme do të nënshtrohen një dëmshpërblimi të tillë, me kusht që pala që është përgjegjëse për dëmshpërblimin e palës tjetër do të ketë të drejtën të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen në lidhje me pretendimin, veprimin, padinë ose procedimin me shpenzimet e veta dhe përmes këshilltarit ligjor të zgjedhur prej saj.

(4) Asnjë palë e cila ka të drejtën për dëmshpërblim nuk është e detyruar të zgjidhë kërkesat, veprimet, paditë ose procedurat në lidhje me të cilat ata kanë të drejtë për dëmshpërblim nga pala tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër përgjegjëse për dëmshpërblimin nëse një palë tjetër plotëson kërkesat e përmendura tek ky nen pëlqimi i të cilit nuk do të mbahet ose shtyhet në mënyrë të paarsyeshme.

### **Neni 13**

#### **Riparimet e dëmtimeve ne terminal**

(1) Operatori (ose ndonjë prej filialeve të tij) duhet të ketë të drejtën të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm në lidhje me riparimin që i ngarkohet çdo pale të dëmshpërblyer të Përdoruesit të Terminalit.

(2) Në masën ku Përdoruesi i Terminalit është përgjegjës për dëmtimin e mjedisit në përputhje me Termat dhe Kushtet e Përgjithshme, Përdoruesi i Terminalit do të dëmshpërblejë Operatorin për kostot e riparimit dhe/ose shlyerjes dhe Operatori nuk do të jetë përgjegjës ndaj Përdoruesit të Terminalit në lidhje me veprimet e riparimit dhe/ose të shlyerjes.

(3) Përdoruesi Terminal gjithashtu do të dëmshpërblejë Operatorin në masën kur veprimet e Operatorit ose Filialit të tij shkaktojnë dëmtime të mëtejshme, nëse:

1. Veprimet nga Operatori ose filialet e tij janë ndërmarrë me pëlqimin paraprak me shkrim të Përdoruesit të Terminalit; ose

2. Operatori ose Filialet (degët) e tij kërkohet që sipas ligjit të ndërmarrin veprime të tilla riparimi; ose

1. Veprimet nga Operatori janë ndërmarrë në bashkëpunim me Kompania e sigurimeve të Përdoruesit të Terminalit dhe çdo autoritet kompetent përkatës.

(4) Pavarësisht paragrafit 3 të këtij neni, nëse Operatori ose filiale të tij kanë vepruar me neglizhencë të rëndë ose sjellje të pavullnetshme në marrjen e veprimeve të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, Përdoruesi i Terminalit nuk do të jetë i detyruar të dëmshpërblejë Operatorin ose ndonjë prej filialeve të tij, në rastet kur veprimet e Operatorit ose Filialeve të tij shkaktojnë dëme të mëtejshme.

### **Neni 14**

#### **Detyrimet e kamat Vonesave**

(1) Nëse, për shkak të ndonjë veprimi ose mosveprimi të Përdoruesit të Terminalit, Transportuesit GNL ose drejtuesit/komandantit të Transportuesit GNL, shkarkimi i ngarkesave nuk përfundon brenda kohës së lejuar, Përdoruesi i Terminalit do t'i paguajë

Operatorit kompensimin për kohën shtesë për çdo ngarkesë të konfirmuar siç parshikohet më poshtë:

– një pagesë për Transportuesit GNL me një kapacitet bruto deri në \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> në shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË në ditë, në lidhje me kohën shtesë dhe/ose Ngarkesën e Konfirmuar;

– një pagesë për Transportuesit GNL me një kapacitet bruto midis \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> dhe \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> në shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË në ditë, në lidhje me kohën shtesë dhe / ose Ngarkesën e Konfirmuar;

– një pagesë për Transportuesit GNL me një kapacitet bruto prej mbi \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> në shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË në ditë, në lidhje me kohën shtesë dhe/ose Ngarkesën e Konfirmuar; dhe

– kostot aktuale të justifikuara të transportit të Gazit Natyror të Lëngshëm (**Boil-Off costs**) nga Përdoruesi i Terminalit gjatë kohës shtesë.

(2) Përdoruesi i Terminalit duhet ti paguajë Operatorit kamatvonesën nëse, për shkak të ndonjë veprimi ose mosveprimi të Përdoruesit të Terminalit, Transportuesit të GNL, ose Transportuesit kryesor të GNL, shkarkimi i Transportit nuk përfundon brënda Periudhës së Lejuar, si më poshtë:

– një pagesë për Transportuesit GNL me një kapacitet bruto deri në \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> në shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË në ditë, në lidhje me periudhën shtesë dhe/ ose Ngarkesën e Konfirmuar;

– një pagesë për Transportuesit GNL me një kapacitet bruto midis \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> dhe \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> në shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË në ditë, në lidhje me periudhën shtesë dhe/ose Ngarkesën e Konfirmuar;

– një pagesë për Transportuesit GNL me një kapacitet bruto prej mbi \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> në shumën prej \_\_\_\_\_ LEKË në ditë, në lidhje me periudhën shtesë dhe/ose Ngarkesën e Konfirmuar; dhe

– kostot aktuale të justifikuara të transportit të Gazit Natyror të Lëngshëm (**Boil-Off costs**) nga Përdoruesi i Terminalit gjatë periudhës shtesë.

(3) Në çdo rast të parshikuar në këtë nen, kompensimi për kamat vonesën do të llogaritet në bazë proporcionale.

## Neni 15

### Përgjegjësia për dëmet

(1) Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj palës tjetër për dëmet indirekte të shkaktuara nga neglizhenca e palës që ka shkaktuar dëmin.

(2) Pagesa për dëmshpërblimin paguhet brënda 20 ditëve të punës pas marrjes së faturës së dëmshpërblimit. Kur data e pagesës nuk është një ditë pune, pagesa do të bëhet në ditën tjetër të ardhshme të punës.

(3) Të gjitha faturat e dëmshpërblimit do të lëshohen dhe paguhen në euro, përveç kur Përdoruesi i Terminalit ka një vend të regjistruar në Shqipëri, në këtë rast shuma në faturë do të paguhet në Lekë në përputhje me kursin këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e lëshimit të faturës.

(4) Fatura e dëmshpërblimit mund të kundërshtohet nga Pala që e ka marrë ose të ndryshohet (modifikohet) nga Pala që e ka lëshuar atë, me anë të një njoftimi me shkrim

dërguar Palës tjetër brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga marrja ose dërgimi i saj, sipas rastit.

## Neni 16

### Forca Madhore

(1) Forcë madhore nënkupton çdo ngjarje dhe / ose rrethanë, ndodhja dhe ndikimi i të cilave është përtej kontrollit të arsyeshëm të Palëve, dhe efektet e së cilës nuk mund të parandalohen ose shmangen. Forca Madhore do të përfshijë, për shembull, ngjarjet ose rrethanat e mëposhtme:

– ç'rregullimet atmosferike, përmbytje, rrufe, tajfune, tornado, uragane ose stuhi të mëdha, tërmete, shpërthime vullkanike, rrëshqitje toke, rrëshqitje, valë baticash, cunami ose katastrofa të tjera natyrore;

– luftërat, bllokadat (e vendeve, porteve ose aeroportëve), sanksionet ndërkombëtare të tregtisë ndërkombëtare, embargo, kryengritje, trazira, akte piraterie, trazira civile, terrorizëm, akte të armiqve publik, sabotim, pushtime, revolucion ose marrje e pushtetit nga ushtria ose mjete të tjera jo-ligjore;

– çdo grevë, bllokim ose çrregullime industrial në një port ose objekt tjetër, në të cilin është ankoruar Njësia e Kapacitetit Qarkullues dhe Rigazifikimit nga e cila ose ku do të kalojë ajo;

– mbetje kimike ose radioaktive ose rrezatim jonizues;

– zjarri, aksidenti, shembja strukturore ose shpërthimi;

– përplasjet, rrënojat e anijeve, rreziqet e lundrimit dhe detare

– epidemitë, plagët ose karantina;

– shkelje e sigurisë kibernetike ose sulmet në internet;

– pengesat zanore;

– katastrofat e aviacionit;

– vendimi i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë i miratuar sipas rregulloreve që drejton sektorin e energjisë në rast çrregullimi në tregun e brendshëm për shkak të mungesës së papritur ose të vazhdueshme të energjisë, dëmtimit të sovranitetit dhe integritetit të vendit dhe katastrofave natyrore ose teknologjike (situata emergjente);

– dështimi, vonesa ose refuzimi i paligjshëm ose diskriminues nga çdo autoritet kompetent për të dhënë, modifikuar ose rinovuar një leje të nevojshme për Operatorin ose Përdoruesin e Terminalit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, ose tërheqja, modifikimi, anulimi ose revokimi nga ky autoriteti kompetent i një leje të tillë, përveç rasteve kur një dështim i tillë, vonesë e paligjshme ose diskriminuese ose refuzim ose tërheqje, modifikim, anulim ose revokim është shkaktuar nga faji i Operatorit ose Përdoruesit të Terminalit (përfshirë shkeljen ose shkeljen e termave dhe kushteve dhe detyrimeve të çdo leje ekzistuese ose kërkesë tjetër);

– shtetëzimi, konfiskimi, shpronësimi, blerja e detyrueshme, pezullimi ose kufizimi i

çfarëdo pasurie (përfshirë Njesinë e Kapacitetit Qarkullues dhe Rigazifikimit) nga çdo autoritet kompetent.

(2) Sa më shpejt të jetë e mundur pas ndodhjes së një ngjarje që Pala e mendon se mund të rezultojë në një Forcë Madhore, dhe në çdo rast brenda tre ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së një Force Madhore, Pala e Prekur duhet të njoftojë për Ndodhjen e Forcës Madhore, Palën tjetër duke e përshkruar në detaje të arsyeshme:

1. ngjarja që shkakton pretendimin e mundshëm ose aktual të Forcës Madhore, duke përfshirë por pa u kufizuar tek vendi dhe koha kur ka ndodhur një ngjarje e tillë;

2. deri në masën e njohur ose të përcaktuar, detyrimet që mund të jenë ose janë vonuar ose parandaluar gjatë performancës dhe periudhës së vlerësuar gjatë së cilës një performancë e tillë mund të ndërpritet ose zvogëlohet, duke përfshirë edhe shkallën e vlerësuar të një uljeje të tillë të performancës; dhe

3. të dhëna të detajuara të aktiviteteve që duhet të zbatohen për të siguruar rifillimin e plotë të kryerjes normale të detyrimeve sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit.

(3) Njoftimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni plotësohen dhe perditesohen në intervale të arsyeshme gjatë periudhës së Forcës Madhore, duke specifikuar veprimet e ndërmarra për të korrigjuar rrethanat që shkaktohen nga kjo Forcë Madhore dhe datën kur Forca Madhore dhe efektet e saj pritet të përfundojnë. Pala e Prekur do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të zbutur efektet e Forcës Madhore dhe për të rifilluar kryerjen normale të detyrimeve sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, sa më shpejt që të jetë e mundur.

(4) Në masën që kryerja e detyrimeve nga Pala e prekur pengohet ose vonohet nga një Forcë Madhore, këto detyrime do të ndërpritin dhe Pala e prekur nuk do të jetë përgjegjëse për mospërbushjen së tyre gjatëkohëzgjatjes së Forcës Madhore. Pala e Prekur do të përpiqet që të lehtësojë efektet e forcës madhore dhe të rifillojë performancën sa më shpejt që të jetë e mundur. Pala e prekur do të jetë përgjegjëse për dëmet për çdo vonesë ose dështim në performancë nëse nuk përpiqet për të kapërcyer ose zbutur efektet e Forcës Madhore,

(5) Kur Operatori është Pala e prekur nga forca madhore, Përdoruesi i Terminalit do të vazhdojë ti paguajë Operatorit tarifën e kapacitetit të rigazifikimit të GNL-së në raport me shërbimet që ofrohet aktualisht.

(6) Kur Përdoruesi i Terminalit është Pala e prekur nga forca madhore, do të vazhdojë ti paguajë Operatorit tarifën e kapacitetit të rigazifikimit të GNL-së në shumën e plotë për 30 ditët e para pas Forcës Madhore, në shumën 75% të shumës së plotë për 30 ditët e ardhshme, dhe 50% të shumës së plotë për kohëzgjatjen e mbetur të Forcës Madhore.

(7) Nëse një ose më shumë Forca Madhore parandalojnë ose vonojnë Palën e Prekur për të kryer të gjitha ose një pjesë thelbësore të detyrimeve të saj ose ndonjë prej detyrimeve të saj sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, për një periudhë të vazhdueshme prej 3 muajsh ose më shumë, atëherë Pala që nuk është Palë e Prekur do të ketë të drejtën të përfundojë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit.

(8) Në mënyrë që Pala që nuk preket nga forca madhore të ketë të drejtën të ndërpresë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit, përveç kushteve të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni, në rast të një forcë madhore, Pala duhet të parandalohet nga përdorimi i pandërprerë i Kapaciteti të rigazifikimit të GNL në shumën prej të paktën 30% të kapacitetit të kontraktuar të rigazifikimit të GNL për atë vit gazi, në përputhje me Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit.

(9) Në rastin e një Force Madhore, kur nuk rregullohet nga këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme, Palët do të kenë të drejta dhe detyrime siç parashikohen në rregulloret që rregullojnë sektorin e energjisë dhe rregulloret që rregullojnë detyrimet civile.

(10) Nëse, në çdo kohë Njësia e Kapacitetit Qarkullues dhe Rigazifikimit:

– përfundon në humbje totale, tarifa për përdorimin e Terminalit nuk do të paguhet dhe Operatori mund të përfundojë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit në kohën dhe ditën e humbjes së tij; ose

– deklarohet në humbje totale, tarifa e Përdorimit të Terminalit nuk do të paguhet dhe Operatori mund të përfundojë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit në kohën dhe ditën në të cilën nënshkruetit e Njesisë së Kapacitetit Qarkullues dhe të Rigazifikimit dakordësojnë që është një humbje totale konstruktive, e kompromentuar, e rregulluar ose, nëse një marrëveshje e tillë nuk është arritur me nënshkruetit e Njesisë së Kapacitetit Qarkullues dhe të Rigazifikimit, në ditën kur gjykohet nga një gjykatë kompetente se humbja totale ka ndodhur; ose

– është zhdukur, atëhere tarifa për përdorimin e Terminalit nuk do të paguhet dhe Operatori mund të përfundojë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit në kohën dhe ditën kur është dëgjuar për herë të fundit në lidhje me Njësinë e Kapacitetit Qarkullues dhe të Rigazifikimit.

## Neni 17

### Ndërprerja e Shërbimeve të kontraktuara

(1) Operatori mund të përfundojë ofrimin e të gjitha shërbimeve që u nënshtrohen këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme nëse Përdoruesi i Terminalit nuk ka shlyer për më shumë se 30 ditë dy fatura të njëpasnjëshme të paraqitura për përdorimin e Terminalit në përputhje me Nenin 6 të këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme ose ka një shkelje më të gjatë të detyrimit të pagesës nga Përdoruesi Terminal, ose nëse Përdoruesi Terminal nuk ka arritur të rinovojë Garancinë Bankare në përputhje me këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme.

(2) Shkelje e zgjatur e detyrimeve të pagesës referuar në paragrafin 1 të këtij neni nga Përdoruesi i Terminalit do të konsiderohet se ekziston, nëse borxhi nuk paguhet brenda 10 ditëve të punës nga data në të cilën kërkesa është paraqitur përmes email-it, shërbimit korrier ose sistemit dhe nëse Përdoruesi i Terminalit nuk paguan këtë shumë ose raporton ndonjë mospërputhje sipas këtyre Termave dhe Kushteve të Përgjithshme.

(3) Ndërprerja e Shërbimeve do të hyjë në fuqi nga momenti kur Përdoruesi i Terminalit njoftohet për ndërprerjen, përveç se për shërbimet e kontraktuara për Ditën e Gazit në proces, për të cilat pezullimi do të hyjë në fuqi nga Dita tjetër e Gazit.

(4) Pasi Përdoruesi i Terminalit të ketë kryer në mënyre vullnetare pagesë për të gjitha shumat e papaguara së bashku me interesin përkatës, si dhe të gjitha shumat fikse që ishin grumbulluar gjatë periudhës së ndërprerjes së shërbimeve, Operatori menjëherë do të rifillojë ofrimin e Shërbimeve, dhe rifillimi në fjalë do të jetë efektiv nga Dita tjetër e Gazit pasi të ketë njoftuar Përdoruesin e Terminalit për rivendosjen e ofrimit të shërbimeve.

(5) Në rast të një kufizimi ose përfundimi të ofrimit të shërbimit për shkak të rrethanave që i ngarkohen detyrimeve të Operatorit dhe për të cilat Operatori është përgjegjës në përputhje me këto Terma dhe Kushte të Përgjithshme, Rregullat dhe Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit, kur dëmi ka ndodhur për Përdoruesit e Terminalit, Operatori është përgjegjës për shpenzimet e bëra për Përdoruesit e Terminalit.

(6) Në çdo rast, ndërprerja nuk do ta çlirojë Përdoruesin e Terminalit nga detyrimi i tij për të përmbushur të gjitha detyrimet e papaguara të pagesës ose ndonjë nga ato që mund të lindin në të ardhmen, përfshirë interesin e papaguar të përllogaritur.

(7) Gjatë periudhës së ndërprerjes së Shërbimeve, Përdoruesi i Terminalit nuk do të rezervojë Kapacitete shtesë të Rigazifikimit të GNL-së.

## **Neni 18**

### **Mirëmbajtja dhe kohëzgjatja e marrëveshjes**

(1) Gjatë mirëmbajtjes së Terminalit, Operatori do të ketë të drejtë të ndërpresë pjesërisht ose plotësisht Shërbimet, siç specifikohet në përputhje me Rregulloren e GNL-së.

(2) Operatori ka të drejtë të kufizojë ose ndërpresë Shërbimet edhe në raste të tjera kur një e drejtë ose detyrim i tillë parashikohet sipas legjislacionit të miratuar për sektorin e gazit natyror

(3) Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit do të pushojë të jetë efektive me përfundimin e Periudhës së Shërbimit (këtu dhe më poshtë: Data e Fundit të Shërbimeve).

(4) Operatori mund të përfundojë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit për arsyet e mëposhtme:

1. bazuar në marrëveshjen e përbashkët nga të dy Palët;

2. në rastet e një zgjatje të Forcës Madhore ose humbjes së Njesisë së Kapacitetit Qarkullues dhe të Gazifikimit në përputhje me dipsozitat e Termave dhe Kushteve të Përgjithshme;

3. pas përfundimit të periudhës 30-ditore kur Përdoruesi i Terminalit njoftohet për ndërprerjen e ofrimit të shërbimit për shkak të mos pagimit të tarifës së Terminalit nëse arsyet e ndërprerjes nuk janë eliminuar,

4. nëse, për shkak të mospërputhjes të Përdoruesit të Terminalit me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit, Operatori ndërpret shërbimet më shumë se katër herë brenda një viti. Në këtë rast, përpara se të ushtrojë të drejtën për të përfunduar Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit, Operatori do të mundesojë një periudhë shtesë jo më shumë se 10 ditë që Përdoruesi i Terminalit të jap fund kësaj situatë. Nëse periudha e parashikuar përfundon dhe Përdoruesi i Terminalit nuk e rregullon situatën, Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit do të konsiderohet e përfunduar në bazë të ligjit.



5. nëse Përdoruesi i Terminalit nuk arrin të sigurojë ose rinovojë Garancine Bankare;
6. nëse Përdoruesi i Terminalit nuk arrin të bëjë një sigurim të detyrueshëm brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit nga Operatori, sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit;
7. në rastin kur Përdoruesi i Terminalit shkel ndonjë nga detyrimet e tij të tjera materiale sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit, dhe shkelja nuk rregullohet brenda 10 ditëve nga dorëzimi i njoftimit të përfundimit; nëse periudha e parashikuar kalon dhe Përdoruesi i Terminalit në mungesë nuk e rregullon situatën, Marrëveshja e Përdorimit të Terminalit do të konsiderohet e përfunduar në bazë të ligjit;
8. nëse Përdoruesi i Terminalit nuk paguan detyrimet sipas Marrëveshjes së Përdorimit të Terminalit edhe pasi Operatori të ketë njoftuar për një periudhë shtesë.
9. Marrëveshja e përdorimit të terminalit do të përfundojë në datën e përfundimit të shërbimeve.

## **Neni 19**

### **Zgjidhja e Mosemarreveshjeve midis Palëve**

(1) Palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet e tyre, në rast të kundërt do t'i drejtohen ERE-s, dhe më pas gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

(2) Përdoruesi i Terminalit mund të ndërpresë/përfundojë Marrëveshjen e Përdorimit të Terminalit për arsye të mëposhtme:

1. në bazë të një marrëveshje dypalëshe nga të dy Palët;

2. në rastet e shtyrjes/zgjatjes së Forcës Madhore;

